



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo

<http://kk.rks-gov.net/istog/>



Komuna e Istogut  
Opština Istok  
Municipality of Istog

Tel: 038/200 438 14

---

Draft Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) për Planin Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave (PNMIM) për rajonin e Dukagjinit

---

## P R O C E S V E R B A L

Nga dëgjimi publik për Draft Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM) për Planin Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave (PNMIM) për rajonin e Dukagjinit mbajtur më: 13.06.2025, në Sallën e Kuvendit Komunal, filluar me punë në ora 11:00.

Në Dëgjim ishin të pranishëm:

1. Illir Ferati, Kryetar;
2. Drejtor të drejtorive Komunale;
3. Ardon Arifaj, Zyra e Kryetarit
4. Liliana Frrokaj, Zyra e Kryetarit;
5. Alketa Bujupaj, Zyra e Kryetarit
6. Jeta Balaj, Zyra për Informim
7. Naser Gjocaj, Zyra e Shërbimeve Publike

Mbledhja ishte e hapur dhe në mbledhje ishin të pranishëm: Kryetari i komunës, z. Ilir Ferati dhe Drejtoret e Drejtorive

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Drejtori i Shërbimeve Publike, z. Abedin Kabashi.

Drejtori, z. **Abedin Kabashi** – përshëndeti të gjithë të pranishmit në këtë mbledhje dhe hapi dëgjimin publik për Draft Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM) për Planin Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave (PNMIM) për rajonin e Dukagjinit dhe për këtë mbledhje propozoi këtë rend dite:

## R E N D D I T E

1. Njoftimi për Draft Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM) për Planin Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave (PNMIM) për rajonin e Dukagjinit,
2. Pyetje dhe Përgjigje

Konsultim publik për Draft Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM) për Planin Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave (PNMIM) për rajonin e Dukagjinit

Konsultimi publik u mbajt në lidhje me Draft Vlerësimin Strategjik Mjedisor për Planin Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për komunat Pejë, Istog, Klinë, Deçan dhe Junik. Qëllimi i takimit ishte informimi i publikut dhe marrja e komenteve lidhur me ndikimet mjedisore të planit.

Takimi u hap nga përfaqësuesi i komunës pritëse, i cili sqaroi rëndësinë e bashkëpunimit ndërkomunal në menaxhimin e mbeturinave dhe nevojën për një qasje të qëndrueshme mjedisore. U prezantuan objektivat kryesore të planit dhe masat e propozuara.

Gjatë prezantimit u diskutuan ndikimet e mundshme në mjedis, shëndetin publik dhe resurset natyrore. U theksua rëndësia e riciklimit, reduktimit të mbeturinave dhe edukimit të qytetarëve për mbrojtjen e mjedisit.

Pjesëmarrësit shprehën shqetësime dhe dhanë rekomandime lidhur me lokacionet e menaxhimit të mbeturinave, monitorimin mjedisor dhe përfshirjen e komunitetit lokal në zbatimin e planit.

Në përfundim, u theksua se komentet e pranuar do të dokumentohen dhe do të integrohen në versionin final të VSM-së dhe planit ndërkomunal.  
Faleminderit shumë!

**Procesmbajtës:**  
**Ardon Arifaj, Zyrtar për Informim dhe Monitorim të Mediave**

